



Data: 05 maj 2018

Buletin Informativ

Nr.4, 2018

Zhvillohet trajnimi i grupit të 1 të OPK-ve për DVP-në e Elbasanit.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për policimin në komunitet të DVP Elbasan si zgjedhur pilot, Programi Suedez "Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri" në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë dhe DVP Elbasan organizuan një trajnim 5 ditor me shefat e seksioneve të Policimit në Komunitet si dhe me Ndhmës Specialistë të Policimit në Komunitet të 5 komisariateve të D.V.P. Elbasan. Ky trajnim u zhvillua në datat 15-17 dhe 22-23 maj 2018 në Elbasan.



Përveç temave teorike mbi Policimin në Komunitet të tilla si: Policimi në Komunitet si filozofi, paradigma e ndryshimit, sistemi dhe elementet e Policimit në Komunitet, u trajtuan në mënyre praktike tema siç ishin roli, detyrat dhe përgjegjësitë e SPK-së, parandalimi në rendin publik, veprimi proaktiv në vend të atij reagues, bashkëpunimi me qytetarët dhe aktorët e tjerë të komunitetit etj.

Pjesëmarrësit e vlerësuan angazhimin, eksperiencën e trajnuesve dhe metodologjinë e përdorur. Në muajt në vazhdim, e gjithë pjesa tjetër e Ndhmës Specialistëve të Policimit në Komunitet si dhe drejtuesve të tyre të DVP Elbasan do trajnohen nga Programi.

Pjesëmarrësve iu bë një intervistë e shkurtër në grup dhe individualisht në lidhjen me trajnimin e zhvilluar:

- Si u ndjetë gjatë trajnimit? A ishte interesant?**

Jemi ndjerë shumë mire në këtë trajnim si në aspekt të menaxhimit të tij, por çka është edhe më e rëndësishme për punën tone të përditshme kemi mësuar shumë, sidomos nga përvoja e ekspertëve të huaj. Ata ndanë me ne përvojën gjermane të policimit në komunitet dhe shpjegimi i kësaj filozofie të policimit na e bëri edhe më të qartë punën tone dhe se si ne mund ta menaxhojmë atë. Një risi ishte edhe metodologjia e përdorur nga trajnuesit, e cila e bënte shumë më të lehtë kalimin e njohurive të tyre tek ne.

- Sa i vlefshëm është ky trajnim për ju ?**

E quajmë një trajnim të vlefshëm sepse u bë një ballafaqim i mënyrave të punës nga ku dolën në pah problemet që ne si N/SPK hasim dhe se si mund të zbusim efektin e tyre. Metodatat e policimit në komunitet ishin shumë të vlefshme për punën tonë.

- Cilët nga elementët që morët nga trajnimi do ti përdorni në vendin e punës?**

Metodat e punës si punonjës i policimit në komunitet dhe komunikimi me publikun do jenë të vlefshme për punën tone në terren.

- A i ka përmbushur ky trajnim pritshmëritë tuaja?**

Trajnimi nuk është i pari dhe për këtë arsye pritshmëritë ishin të larta. Nga këto 5 ditë mendojmë se janë arritur pritshmëritë dhe sidomos ato për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira evropiane me trajnuesit dhe me njëri –tjetrin. Përfituam ne, por edhe trajnuesit mësuan shumë gjëra nga puna jonë, përkushtimin dhe sakrificën e NSPK.

A mendoni se do jeni më pro-aktivë pas këtij trajnimi për të parandaluar ngjarjet?



